

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK**

SYLLABUSI

Lënda: Sociologji

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Sociologji
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri Veror, Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Beqir Sadikaj Ass.Mexhit Shaqiri
Detajet kontaktuese:	beqir.sadikaj@uni-pr.edu mexhit.shaqiri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
Përshkrimi i lëndës:	<i>Sociologjia është një lëndë e cila mësohet tradicionalisht në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe ka arritur që të zë një vend të rëndësishëm në mesin e shkencave tjera që ligjërohen në këtë fakultet. Kjo lëndë përfshinë temat dhe konceptet bazë lidhur me Sociologjinë në përgjithësi, duke filluar nga burimet e Sociologjisë e deri të themeluesit e saj, lënda trajton poashtu tema të tjera interesante si: Teoritë e ndryshme sociologjike, metodat hulumtuese, grupet shoqërore, familja dhe martesë, shteti dhe teoritë mbi shtetin, kombi dhe nacionalizmi, etj.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Ky kurs ka për qëllim që t’ju ofroj studentëve njohuri të përgjithshme lidhur me fenomenet shoqërore dhe qasjen sociologjike në raport me studimin e këtyre fenomeneve. Në këtë kontekst, studentët do të kenë mundësi që të njihen me tema të shumta të cilat do të jenë me interes për ta, si: Dhuna në familje, kombi dhe nacionalizmi, familja dhe ndryshimet që kanë ndodhur në këtë institucion, politika dhe partitë politike, religjioni, si dhe metodat e kërkimit. Të gjitha këto tema si dhe qasja kritike e cila aplikohet në Sociologji do t’i ndihmoj studentëve të Fakultetit Juridik që të krijojnë një perspektivë plotësuese në njohjen e fenomeneve shoqërore, duke rezultuar në</i>

	<i>fund me një formim më të plotë akademik dhe profesional të tyre.</i>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Studenti tregon zotërimin e koncepteve bazë sociologjike;</i> • <i>Aplikimi qasjes kritike dhe mendimit kritik mbi konceptet e ndryshme të trajtuar në kuadër të kursit;</i> • <i>Përfundimi me sukses i punimeve seminarike, punimeve hulumtuese individuale dhe në grup;</i> • <i>Demonstrimi i pavarësisë individuale në mënyrën e të menduarit, i artikuluar në paraqitjet me shkrim dhe me gojë.</i> 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	30	45 / 15	
Ushtrime teorike/laboratorike	15	45 / 15	
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	30	30 / 15	
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	15	45 / 15	
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	60	30 / 4	
Projektet,prezantimet ,etj	15	45 / 15	
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Metodologjia e aplikuar gjatë ligjërimit të lëndës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në: Metodën interaktive, punimet me shkrim, projektet hulumtuese duke përfshi punën individuale dhe atë në grupe,prezantimet e ndryshme, debatet, etj.</i>		
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes dy kolekfiumeve të rregullta, punimeve të ndryshme dhe</i>		

	<i>prezantimeve si dhe provimit final.</i>
Literatura	
Literatura bazë:	Prof.Dr. Beqir Sadikaj, Sociologjia e përgjithshme, Prishtinë: 2016. Anthony Giddens, Sociologjia, Tiranë: 1997. Gjergj Rrapi, Sociologjia, Prishtinë: 1997.
Literatura shtesë:	Irena Nikaj, Sociologjia, Tiranë: 2001. Tonin Gjuraj, Hyrje në Sociologji, Shkodër, 2003.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Sociologjia dhe aktualiteti i saj: <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e të mësuarit të Sociologjisë - Përkufizimi i objektit të Sociologjisë - Objekti i studimit të Sociologjisë.
Java e dytë:	Raporti i Sociologjisë më shkencat tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Sociologjia dhe Historia - Sociologjia dhe antropologjia - Sociologjia dhe Ekonomia - Sociologjia dhe Shkencat politike - Sociologjia dhe Psikologjia - Sociologjia dhe sociologjitë e veçanta.
Java e tretë:	Metodat e studimit shkencor dhe Sociologjia: <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e metodave shkencore në studimet e fenomeneve shoqërore - Metodat e hulumtimit në Sociologji - Metoda e të vërejturit - Intervista - Anketa - Eksperimenti
Java e katërt:	Metodat e studimit shkencor dhe Sociologjia: <ul style="list-style-type: none"> - Metoda historiografike - Metoda komperative apo krahasuese - Metoda sociometrike - Analiza e përmbajtjes - Fazat e hulumtimit shkencor në Sociologji.
Java e pestë:	Burimet e Sociologjisë: <ul style="list-style-type: none"> - Teoritë e para për shoqërinë dhe organizimin e saj - Konceptcionet për shoqërinë në Greqinë antike - Sofistët për shoqërinë dhe njeriun - Platoni dhe pikëpamjet e tij për organizimin e shoqërisë dhe shtetit - Aristoteli dhe pikëpamjet e tij për realitetin shoqëror dhe politik në Greqi - Mendimtarët romak për shoqërinë, Ciceroni dhe Seneka.
Java e gjashtë:	Burimet e Sociologjisë: <ul style="list-style-type: none"> - Mendimet për shoqërinë në Mesjetë

	<ul style="list-style-type: none"> - Aurelije Augustini - Toma Akuini dhe pikëpamjet e tij për njeriun dhe shoqërinë - Iben Halduni dhe pikëpamjet e tij për organizimin e suksesshëm të shoqërisë. - Mësimet e kohës së re për shoqërinë - Nikolla Makiaveli dhe pikëpamjet e tij - Zhan Bodeni, përfaqësues i kohës së re - Tomas Hobsi - Xhon Loku - Zhan Zhak Ruso.
Java e shtatë:	Themeluesit e Sociologjisë: <ul style="list-style-type: none"> - Sen Simoni dhe pikëpamjet e tij për studimin dhe organizimin e shoqërisë - Ogyst Konti, themelues i Sociologjisë - Herbert Spenseri-Koncepcionet e tij për Sociologjinë - Emil Dyrkemi-Themelues i Sociologjisë moderne.
Java e tetë:	Themeluesit e Sociologjisë: <ul style="list-style-type: none"> - Maks Veber, pikëpamjet e tij për Sociologjinë dhe organizimin shoqëror - Teoria e Marksit-Mënyrë e re e trajtimit të çështjeve shoqërore dhe organizimit shoqëror - Teoritë Sociologjike - Funkcionalizmi dhe Strukturalizmi.
Java e nëntë:	Shoqëria njerëzore dhe paraqitja e njeriut <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizimi sociologjik i shoqërisë njerëzore - Llojet e shoqërive njerëzore - Fenomenet, proceset dhe krijesat shoqërore - Struktura shoqërore dhe organizimi shoqëror.
Java e dhjetë:	Pabarazia shoqërore: <ul style="list-style-type: none"> - Stratifikimi dhe pabarazia klasore - Klasat shoqërore, lufta e klasave (Teoria e konfliktit) - Marksi për klasat - Maks Veber për klasat - Format historike të pabarazisë - Mobiliteti shoqëror
Java e njëmbëdhjetë:	Grupet shoqërore dhe rëndësia e tyre në strukturën shoqërore: <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizimi i grupit shoqëror - Llojet e grupeve shoqërore - Martesa dhe familja - Përkufizimi i familjes - Zhvillimi historik i familjes dhe llojet e saj - Martesa dhe format - Problemet dhe perspektiva - Divorci - Bashkëjetesa - Dhuna në familje

Java e dymbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Religjioni – feja - Përkufizimi i religjionit - Feja gjatë historisë - Fetë kryesore botërore - Religjioni në shoqërinë bashkëkohore.
Java e trembëdhjetë:	Shteti dhe përkufizimi i tij: <ul style="list-style-type: none"> - Teoritë për shtetin - Tipet dhe format e shtetit
Java e katërbëdhjetë:	Kombi dhe nacionalizmi: <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi historik i kombit - Çka është etnia - Populli si paraardhës i kombit - Kombi i kulturës dhe kombi i shtetit - Përkufizimi i kombit - Nacionalizmi - Llojet e nacionalizmit - Kombi dhe globalizimi
Java e pesëmbëdhjetë:	Politika dhe partitë politike: <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizimi i politikës - Zhvillimi historik i partive politike - Partitë politike në Kosovë - Përkufizimi i partive politike - Organizimi i partive politike - Anëtarësimi në parti politike - Financimi i partive politike - Përcaktimi ideologjik i partive politike
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p><i>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes prezantohen në çdo fillim viti shkollor nga ana e mësimitdhënësit, poashtu këtu përfshihen edhe kriteret për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve.</i></p> <p><i>Rregullat e mirësjelljes kërkojnë mbajtjen e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, respektimi i orarit, etj.</i></p> <p><i>Ndërsa kriteret për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve kërkojnë që studenti t'i përmbahet orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, etj.</i></p>	